



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-8364/20 datë:02.06.2020



Npi – 01/121 datë: 05.06.2020

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.7 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve 01Nr.06/2005-43, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 05.06.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IV- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 05.06.2020 (e premte) në ora 14.00 h. në sallën e Kuvendit Nr.01

Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit për Komunitete: z.Rahman Kadrija, znj.Fatmire Ferati, z.Muhamet Ademaj, dhe znj.Diarta Vishesella, kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri; Nga ZKF-ë znj.Kimete Ukaj; Praktikanti, z.Egzonit Jakupi; Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Rahman Kadrija, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023,
2. Informatë nga zyra e punës dhe punësimit lidhur me pakon e ndihmës qeveritare për të pa punët (komuniteti pakicë),
3. Informatë nga ZKKK-ja për aktivitetet,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj zyrtare kryesore financiare; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, prezantoi në pika të shkurtra Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023. Ky pra është dokumenti kryesor që përcakton kornizat e miratimit të Buxhetit të Komunës së Shitimes. Drafti është hartuar sipas dokumentit bazë të KAB-it ku janë vendosë tavani i shpenzimeve mbi të cilin nuk mund të kalohet, gjithashtu janë konsultuar edhe drejtoritë, dhe do të ketë diskutim publik me qytetarë. Baza ligjore ekziston, dokumentin si draft e keni pranuar me kohë, kështu që unë jam këtu për tu përgjigjur pyetjeve të juaja eventuale, (shih dokumentin)

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Përshëndetje, unë e kam lexuar KAB-in, dhe siç e dimë do të shkojë në diskutim publik. Është mirë që në procesin e diskutimit publik që do të mbahet të jenë aktiv edhe pjesëtarët e komunitetit pakicë, kështu që tani për tani unë më shumë nuk kam se çka të diskutojë.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, KAB-i siç e dimë do të shkojë në diskutim publik. Është mirë që edhe komuniteti pakicë me i dhënë kërkesat e tyre. Mirëpo problemi është që në diskutim publik po dalin shumë pak. Unë kërkoj që organizimi i procesit të diskutimit publik të organizohet më mirë jo vetëm në qendër por edhe nëpër fshatra.

znj.Fatmire Ferati; Përshëndetje, mirë që KAB-i shkon në diskutim publik, dhe kërkesa ime është që të paktën nga një përfaqësues i lagjeve të marrin pjesë në takim me qëllim që ti paraqesin kërkesat e tyre.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Sa i përket Infrastrukturës, në bashkëpunim me ZKKK-në ne i kemi projektet e gatshme, po ashtu kemi një bashkëpunim të mirë me drejtorinë për planifikim urban, kadastër dhe gjeodezi.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Unë e kam lexuar KAB-in dhe e kam parë se janë përfshirë të gjitha ato që faktikisht ne i kemi planifikuar, nëpër lagje dhe vendbanime ku ka pjesëtar të komunitetit pakicë. Në bashkësitë e Shtimes duhet ende të hulumtohet nëse ka diçka nga projektet që kishte me ndikuar në përmirësimin e jetës të komunitetit pakicë. Mirëpo sigurisht që do të diskutojmë edhe në diskutimin publik që do të mbahet.

Pika 2

Informatë nga zyra e punës dhe punësimit lidhur me pakon e ndihmës qeveritare për të pa punët (komuniteti pakicë),

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Ibrahim Demiri.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; I kemi në formë elektronike të regjistruar që kanë përfituar 17 persona, të tjerët janë në pritje, por ka mundësi që të përfitojnë edhe ata. Informatën e keni të shkruar dhe e keni marrë me kohë, prandaj unë nuk do ta zgjati më shumë. Nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur, (shih dokumentin).

Pika 3

Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Ibrahim Demiri.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Informatën e kemi përgatitur në formë të shkruar dhe ua kemi dërguar, (shih dokumentin).

z.Muhamet Ademaj; E falënderoj Ibrahimin për Informatën. Te mësimi on-line te nxënësit e komunitetit pakicë ka pasur shumë mungesë. Kam edhe disa nxënës të mi e të cilëve unë kam bërë përpjekje për me ju ndihmuar. Unë po them se ka qenë mirë që me biseduar me prindërit e këtyre nxënësve që së paku me mund ata me u notuar.

Pika 4

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Diarta Vishesella; Nuk e di nëse ka mundësi me marrë Komuna në menaxhim çështjen për me organizuar fushatën për regjistrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta?

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 14.48 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Rrahman Kadrija

